



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASHKISË KORÇË

VENDIM

Nr. 31, Datë 24.02.2022

PËR MIRATIMIN E PROCES VERBALIT TË MBLEDHJES TË DATES 10.02.2022
TË KËSHILLIT TË BASHKISË KORÇË

Këshilli i Bashkisë Korçë në mbledhjen e tij të datës së sotme, pasi lexoi proces verbalin e zbardhur nga Sekretarja e Këshillit të mbledhjes të datës 10.02.2022, në mbështetje të ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore" neni 53, pika 8 dhe neni 54, gërma k) si dhe neni 92 e Rregullores së Funkcionimit të Këshillit të Bashkisë Korçë miratuar me VKB nr. 80, datë 30.07.2020;

VENDOSI

1. Të miratojë proces verbalin e mbledhjes të Këshillit të Bashkisë Korçë, të datës 10.02.2022 bashkangjitur.
2. Kopja e proces verbalit të miratuar administrohet nga Sekretarja e Këshillit sipas procedurave ligjore.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Erjon NEXHIPI



PROÇESVERBAL I MBLEDHJES DATË 10.02.2022

Kryesuesi i mbledhjes është kryetari i Këshillit z.Erjon Nexhipi

Ora e hapjes së mbledhjes: 13:00

Zhvillimi i mbledhjes : në sallën e Këshillit Bashkiak

Këshilltarë pjesëmarrës në momentin e hapjes së mbledhjes: 24

Sekretari i Këshillit deklaroi kuorumin prej 24 këshilltarësh.

Të pranishëm nga administrata e Bashkisë: Kryetari i Bashkisë z.Sotiraq Filo dhe drejtorë të ekzekutivit

Të pranishëm në mbledhje qytetarë: 1

Pika 1 e rendit të ditës

PËR MIRATIMIN E RENDIT TË DITËS.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Pika e parë e rendit të ditës, në miratimin e rezolutës që ne realizuam herën e kaluar, kemi harruar një pikë të rëndësishme, pjesën që duhet t'ia dërgonim edhe KLGJ-së, kështu që duhet një shtesë e vogël tek ai material, për të cilin besoj se duhet të futet në rendin e ditës për miratim. Së bashku me shtesën e rezolutës, kemi diçka për rendin e ditës? Kalojmë në votim.

Hidhet në votim dhe miratohet

Vota PRO 24

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Pika 2 e rendit të ditës

PËR MIRATIMIN E PROÇESVERBALIT TË MBLEDHJES SË KALUAR.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Është shpërndarë me e-mail proçesverbali i mbledhje së kaluar, pra pika 2 e rendit të ditës. Ka diçka për të shtuar mbi proçesverbalin e mbledhjes së kaluar?

Këshilltare I.Nikaj: Mund të shkruhet në proçesverbal që bëhet zhurmë?

Kryetar i Këshillit E.Nexhipi: Ndoshta edhe shkruhet për t'u marrë në konsideratë herë tjetër, kalojmë me votimin.

Hidhet në votim dhe miratohet

Vota PRO 25

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Pika 3 e rendit të ditës

MBI MIRATIMIN E SISTEMIT TË PIKËZIMIT PËR PËRZGJEDHJEN E PËRFITUESVE TË PROGRAMIT "BANESA SOCIALE ME QIRA".

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Komisioni i Mirëqënies Sociale, Strehimit, Rinisë, Barazisë Gjimore, Mosdiskriminimit, të Drejtave të Njeriut, znj. Irena Nikaj mund të vazhdoni.

Këshilltare I.Nikaj: I propozojmë Këshillit Bashkiak miratimin e sistemit të pikëzimit për përzgjedhjen e përfituesve të programit "Banesa sociale me qira", i cili mbështetet në Ligjin nr. 139/2015 datë 17.12.2015, "Për vetëqeverisjen vendore" nenin 8, pika 2, nenin 9, pika 1 dhe 1.1, shkronja "b", nenin 24, 54, në Ligjin nr. 22/2018 "Për Strehimin Social, nenet 15, 16, në VKM 384, datë 12.06.2019, "Për përcaktimin e dokumentacionit që duhet të paraqesë familja për tu strehuar sipas njërit prej programeve sociale të strehimit dhe të afateve, procedurave të miratimit nga organet e qeverisjes vendore" dhe në VKM nr.301, datë 15.04.2020 "Për normat e strehimit për familjet që përfitojnë nga programet sociale të strehimit". Në relacion përmendet gjithashtu se pika 2 e vendimit nr.76, është shfuqizuar me Vendimin e Këshillit Bashkiak nr.82, datë 30.07.2020 "Për një ndryshim në VKB nr.76 datë 18.08.2014, "Për renditjen e aplikantëve për Banesat me Qira Sociale", për të mundësuar rishpërndarjen e Banesave Sociale me Qira. Kriteret në të cilat është bazuar sistemi i pikëzimit për këtë program ndahen në kushtet e strehimit, kushtet sociale, kushtet familjare dhe ato ekonomike. Në emër të komisionit ju ftoj për miratim.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Nga këshilltarët apo ekzekutivi ka diçka për të shtuar? Kalojmë në votim.

Hidhet në votim dhe miratohet

Vota PRO 26

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Pika 4 e rendit të ditës

MBI MIRATIMIN E SISTEMIT TË PIKËZIMIT PËR PËRZGJEDHJEN E PËRFITUESVE PËR PROGRAMIN "SUBVENCIONI I INTERESAVE TË KREDISË".

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Komisioni i Mirëqënies Sociale, Strehimit, Rinisë, Barazisë Gjimore, Mosdiskriminimit, të Drejtave të Njeriut, znj. Irena Nikaj mund të vazhdoni.

Këshilltare I.Nikaj: I propozojmë Këshillit Bashkiak miratimin e sistemit të pikëzimit për përzgjedhjen e përfituesve për programin "Subvencioni i interesave të kredisë" bazuar në VKM

nr.453, datë 03.07.2019, "Për masën e subvencionimit të interesave të kredisë dhe procedurën e dhënies së tij për familjet që përfitojnë banesë me kosto të ulët me kredi të lehtësuar nga shteti", Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka bërë përzgjedhjen e bankave që do të menaxhojnë projektin për kreditimin e familjeve që përfitojnë banesë me kosto të ulët nëpërmjet subvencionimit të interesave të kredisë nga buxheti i shtetit dhe konkretisht janë : Banka Raiffeisen , Banka Kombëtare Tregtare dhe Banka Intesa Sanpaolo. Këto familje përfitojnë një kredi me interes jo më të lartë se 3% në vit, me afat maksimal shlyerje deri 30-35 vjet, sipas bankave. Nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Bashkisë Korçë, i janë mundësuar 120 përfitues. Përparësi në përzgjedhjen e tyre do të kenë: çiftet e reja,të rinj me moshë jo më të madhe se 35 vjeç; individë/familje të komunitetit rom e egjiptian; gra kryefamiljare/gra të dhunuara. Edhe për këtë sistem kemi kriteret të ndara në kushtet e strehimit, kushtet sociale, kushtet ekonomike, familjare dhe kushtet specifike. Ju ftoj për miratim.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Ka diçka për të shtuar nga këshilltarët apo ekzekutivi? Unë kam një pyetje, ka diferencë një program nga një tjetër, se mesa po dëgjoj më duken njësoj? Nëse janë njësoj t'i përmbledhim atëherë.

Këshilltare I.Nikaj: Jo nuk janë njësoj, ndryshojnë tek pikët, ndryshojnë tek kriteret.

Ekzekutivi M.Balli: E rëndësishme është që secili program të ketë kriteret dhe specifikat e veta, ku secili prej tyre përfshin grupe të ndryshme shoqërore duke mos përjashtuar askënd. Nëse i referohemi subvencionit të qerasë, ky program ka për qëllim të mbulojë ato familje që nuk kanë asnjë mundësi ekonomike.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Diferenca e tyre qëndron tek të ardhurat, ka familje pa të ardhura fare dhe ka familje që kanë një nivel të caktuar të ardhurash dhe ato përshtaten në bazë të tyre se cilit program do t'i përkasin, ku do aplikojnë dhe ku mund të fitojnë.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Një pyetje më teknike, një çift i ri i sapomartuar për shembull, nga subvencionit i interesave të kredisë përfiton?

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Kjo varet nga niveli i të ardhurave, sepse nëse ata kanë një nivel të ardhurash që iu mundëson marrjen e një kredie dhe shlyerjen e saj pastaj e mundëson vet marrjen e shtëpisë.

Ekzekutivi M.Balli: Niveli i të ardhurave ndryshon nga viti në vit dhe ata që kanë një nivel social të caktuar e sigurojnë vet strehimin.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Nga këshilltarët ka diçka për të shtuar? Kalojmë në votim. Hidhet në votim dhe miratohet

Vota PRO 27

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Pika 5 e rendit të ditës

MBI MIRATIMIN E SISTEMIT TË PIKËZIMIT PËR PËRZGJEDHJEN E PËRFITUESVE TË PROGRAMIT "SUBVENCIONI I QIRASË".

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Jemi përsëri tek Komisioni i Mirëqënies Sociale, Strehimit, Rinisë, Barazisë Gjimore, Mosdiskriminimit, të Drejtave të Njeriut, znj. Irena Nikaj mund të merrni fjalën.

Këshilltari I.Nikaj: Meqënëse Drejtoresha bëri një sqarim të këtyre programeve unë po kaloj direkt tek kriteret. Kushtet e strehimit të cilësuar me 20 pikë janë të përbëra nga ata të cilët: nuk disponojnë asnjë lloj banese në pronësi; kanë ngelur të pastreha, si rezultat i fatkeqësive natyrore, ose zbatimit të një vendimi gjyqësor; banojnë në banesa në rrezik shembje sipas përcaktimeve ligjore dhe rrezikojnë të ngelen të pastrehë; banojnë në banesa të mbipopulluara, sipas përcaktimeve dhe normave në fuqi; banojnë në banesa që prishen ose përjashtohen nga procesi i legalizimit, si rezultat i investimeve publike. Tek kushtet familjare me 20 pikë përfshihen të gjithë ata të cilët janë: të moshuar që kanë mbushur moshën e pensionit dhe që nuk përzgjidhen për t'u strehuar nga institucionet publike të përkujdesit shoqëror; familjet me më shumë se katër fëmijë; çiftet e reja me moshë totale deri në 60 (gjashtëdhjetë) vjeç; familje njëprindërore që kanë ngarkim fëmijë. Tek kushtet sociale me 40 pikë përfshihen të gjithë ata që janë: personat me aftësi të kufizuara, në përputhje me përcaktimet e bëra me vendim të Këshillit të Ministrave për këto kategori dhe me shërbim kujdestarie; persona me statusin e jetimit që nga çasti i daljes nga qendrat e përkujdesit shoqëror e deri në moshën 30 vjeç; emigrantë i rikthyer, punëtorë emigrantë, azilkërkues familje që në përbërje të tyre kanë persona të cilët gëzojnë statusin e ish të përndjekurit politik; familjet e policëve të rënë në detyrë; viktimat të dhunës në familje; familje e mbetur e pastrehë për shkak të lirit të banesave të ish-pronarëve; punonjës i reparteve FNSH dhe RENEA; familje të komunitetit Rom; familje të komunitetit Egjiptian; Vajzë Nënë; viktimë e trafikimit ose viktimë e mundshme të trafikimit; i mitur në konflikte me ligjin sipas parashikimeve të Kodit të Drejtësisë Penale për të mitur, pas ekzekutimit të dënimit; Individë që i përket komunitetit LGBTI, i cili ka një vendim të organit kompetent si viktimë e orientimit seksual ose identitetit gjinor. Së fundmi janë edhe kushtet ekonomike të përbëra nga: të ardhura nën 70% të të ardhurave mesatare; të ardhura 70%-100% të të ardhurave mesatare; Të ardhura 100%-120% të të ardhurave mesatare. Ju ftoj për miratim.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Ka diçka për të shtuar nga këshilltarët? Vazhdojmë me votimin. Hidhet në votim dhe miratohet

Vota PRO 27

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Pika 6 dhe 7 e rendit të ditës

MBI MIRATIMIN E VLERËS MAKSIMALE TË SUBVENCIONIMIT TË QIRASË DHE TË NIVELIT TË QIRASË MESATARE NË TREGUN E LIRË. & MBI MIRATIMIN E SUBVENCIONIMIT TË QIRASË PËR FAMILJET E PASTREHA.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Meqënëse flasim përsëri për Komisionin e Mirëqënies Sociale, Strehimit, Rinisë, Barazisë Gjimore, Mosdiskriminimit, të Drejtave të Njeriut tek të dyja pikat, mendoj znj.Irena mund t'i shpjegoni të dyja njëherësh dhe pastaj i votojmë të ndara.

Këshilltare I.Nikaj: Për pikën 6, i propozojmë Këshillit Bashkiak miratimin e vlerës maksimale të subvencionimit të qerasë dhe të nivelit të qerasë mesatare në tregun e lirë bazuar mbi Ligjin nr. 139/2015 datë 17.12.2015, "Për vetëqeverisjen vendore". Masa e subvencionit përlllogaritet në varësi të të ardhurave të familjes. Kemi apartamente garsoniere për 8.000 lekë; ap. 1+1 për 12.000 lekë; ap. 2+1 për 1.000 lekë dhe ap. 3+1 për 20.000 lekë. Ju ftoj për miratim. Ndërkohë për pikë 7 të rendit të ditës propozojmë miratimin e subvencionimit të qerasë për familjet e pastreha bazuar mbi Ligjin nr.22/2018, "Për Strehimin Social". Pranë Drejtorisë së Strehimit kanë paraqitur kërkesën 20 familje për përfitimin nga ky program dhe pasi mori në shqyrtim kërkesat e aplikantëve, i paraqet Këshillit Bashkiak dokumentacionin mbi miratimin e Subvencionit të Qirasë. Trajtimi nga ky program për këto familje do të jetë për 12 muaj, për periudhën 1 Janar 2022 deri më 31 Dhjetor 2022, sipas kontratave të qirasë për çdo familje dhe kemi gjithashtu edhe listën bashkangjitur ku mund t'i shikoni familjet. Ju ftoj për miratim.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Kam një pyetje, ne vet e kemi evidentuar këtë nivel të vlerave apo na është dhënë?

Ekzekutivi M.Balli: E kemi bërë ne, e kemi përshtatur me tregun e Korçës.

Këshilltare E.Tare: Ka mundësi për shtim të familjeve në nevojë gjatë vitit?

Ekzekutivi M.Balli: Patjetër, ne kemi kërkuar një shtim fondi nga Ministria, por mund të mbështeten edhe nga fondi i vet bashkisë.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Ka diçka nga këshilltarët për të shtuar? Vazhdojmë me votimin.

Hidhet në votim dhe miratohet pika 6 e rendit të ditës

Vota PRO 27

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Hidhet në votim dhe miratohet pika 7 e rendit të ditës

Vota PRO 27

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Pika 8 e rendit të ditës

PËR PËRDORIMIN E TË ARDHURAVE TË TRASHËGUARA TË VITIT 2021 TË BASHKISË, INSTITUCIONEVE TË VARËSISË NË BUXHETIN E VITIT 2022.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Nga ekzekutivi ka diçka për të shtuar?

Ekzekutivi V.Ziko: Në zbatim të ligjit nr.115/2021 “Për buxhetin e vitit 2022”, udhëzimit nr. 9 datë 20.03.2018 i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar, Udhëzimit nr. 25 datë 9.12.2021 “Për procedurat e mbylljes së llogarive vjetore të buxhetit për vitin 2021” Udhëzimit Plotësues nr. 1 datë 10.1.2022 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2022”, Bashkia Korçë dhe Dega e Thesarit kanë kryer aktin e rakordimit të të ardhurave dhe shpenzimeve për mbylljen e buxhetit të vitit 2021. Të ardhurat e vitit 2021 të cilat trashëgohen në vitin 2022 janë në vlerën 191,202,125.94 lekë. Transfertat janë të ndara në: transfertat e pakushtëzuar sektorial 42,103,345.11 lekë; transfertat e pakushtëzuar 18,148,322.29 lekë; transfertat specifike për emergjencat civile 12,893,300 lekë; të ardhurat nga taksat dhe tarifatat vendore 115,609,189.54 lekë dhe sponsorizime 2,447,969 lekë. Të gjitha shifrat janë pasqyruar të detajuara në materialin që ju keni shqyrtuar. Vlen për t'u përmendur se detyrimet e mbartura nga vitet e mëparshme 2019-2020 kanë qënë detyrime të mbartura vit pas viti, ndërkohë këtë vit kemi të mbartura vetëm detyrimet e dhjetorit.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Ka diçka tjetër për të shtuar nga këshilltarët?

Këshilltare I.Nikaj: Unë doja të pyesja pak çfarë ndodhi me diskutimin e herës së kaluar mbi kafshët?

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Tani ne diskutuam edhe herën e kaluar për këtë çështje dhe unë ia u shpjegova situatën, njëkohësisht ne kemi zgjedhur edhe një nënkontraktor për këtë problem. Problemi qëndron tek numri i kafshëve në rrugë, që sa vjen dhe shtohet dhe për shkak të asaj që thamë edhe herën e kaluar që na sjellin kafshë edhe nga qytetet e tjera. Tani ky problem nuk është se ndodh vetëm në qytetin tonë, po ne sigurisht do flasim dhe do përpiqemi ta zgjidhim brenda kushteve tona.

Këshilltare I.Nikaj: Unë kam vite që jetoj në Korçë dhe ky problem nuk është se ka qënë kaq shqetësues, tani kohët e fundit është shndërruar në përmasa të tilla.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Po të shohim njëherë si e kanë zgjidhur vendet fqinje probleme të tilla.

Këshilltare M.Dojçe: Po në qytetin e Ohrit konkretisht situata është e njëjtë, flas nga eksperiencia dhe atë ç'ka kam parë vet.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Unë kur kam biseduar në një takim me një nga përfaqësuesit e BE-së rritur në Suedi, Norvegji diku andej mos gabo, më ka thënë se andej nuk ekzistojnë probleme të tilla, sepse nuk ka kafshë pa zot. Tani ata sigurisht janë shumë të zhvilluar dhe nuk i perceptojnë dot këto probleme, po ne do mundohemi të shohim modelet rreth nesh dhe unë e kam thënë dhe po e them, çfarë sugjerime, ide keni mund të na ndihmoni.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Dakort, unë mendoj të ecim me këto pikat e rendit të ditës dhe nëse ka diçka tjetër për të thënë e diskutojmë në fund të mbledhjes, sepse nëse nisim me gjithë shqetësimet tani në mes të mbledhjes na mbeten pikat pa diskutuar. Edhe unë kam një shqetësim për shembull për gjendjen e rrugicave me borë, por mendoj t'i lemë për në fund të gjitha këto. Kalojmë në votim.

Hidhet në votim dhe miratohet

Vota PRO 27

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Pika 9 e rendit të ditës

PËR MIRATIMIN E RRYTJES SË PLANIT TË BUXHETIT SI DHE KALIMIN E FONDIT PREJ 3,000,000 LEKËSH TË AKORDUARA NGA KËSHILLI I QARKUT PËR PROJEKTIN "QENDRA DITORE PËR MOSHËN E TRETË" TEK FONDACIONI "MISIONI EMANUEL".

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Komisioni i Financave, Buxhetit, Pasurive bashkiake, Planifikimit të Zhvillimit Strategjik të Bashkisë, dhe Mbikqyrjes Financiare, z.Joan Deli mund të vazhdoni.

Këshilltari J.Deli: Me Vendimin e Këshillit të Qarkut nr. 14 datë 22.12.2021 si dhe duke u bazuar në marrëveshjen e bashkëpunimit midis Bashkisë Korçë dhe Këshillit të Qarkut, për projektin "Qendra ditore për moshën e tretë", gjatë vitit 2022 në buxhetin e Bashkisë do të shtohet kontributi financiar i Këshillit të Qarkut në vlerën 3,000,000 lekë, për realizimin e këtij projekti. Ky projekt ka për qëllim të përmirësojë mirëqënien e komunitetit, përmes integritit social dhe reduktimit të varfërisë për të shmangur efektet e izolimit social dhe problematikat e

ndryshme me të cilat përballet Mosha e Tretë. Kjo është një praktikë e njohur që ne kemi miratuar gjatë këtyre viteve, i propozoj Këshillit Bashkiak miratimin e saj.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Nga këshilltarët ka diçka për të shtuar? Një pyetje kisha unë, sa të moshuar përfitojnë nga ky program dhe për sa qendra bëhet fjalë?

Këshilltare E.Tare: Përfitojnë 200 banorë dhe kemi 4 qendra pjesë të saj.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Dakort, kalojmë në votim.
Hidhet në votim dhe miratohet

Vota PRO 27

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Pika 10 e rendit të ditës

PËR MIRATIMIN E PLANIT VJETOR TË PRANIMIT NË SHËRBIMIN CIVIL PËR INSTITUCIONIN E BASHKISË KORÇË PËR VITIN 2022.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Kjo është një praktikë standarte për miratim Anxhela?

Ekzekutivi A.Dishnica: Po.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Dakort, ka diçka për të shtuar? Vazhdojmë me votimin.
Hidhet në votim dhe miratohet

Vota PRO 27

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Pika 11 e rendit të ditës

PËR DISA NDRYSHIME NË VKB NR. 146 DATË 22.12.2021 "PËR MIRATIMIN E NIVELIT TË PAGAVE TË PUNONJËSVE E TË PERSONAVE TË TJERË TË ZGJEDHUR OSE TË EMËRUAR NË INSTITUCIONIN E BASHKISË DHE INSTITUCIONEVE TË VARËSISË PËR VITIN 2022".

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Komisioni i Rregullores, Çështjeve Ligjore dhe Administrative dhe Pasurive të Bashkisë, z.Gjergji Kristo mund të vazhdoni.

Këshilltari Gj.Kristo: Bazuar në nenin 54 të ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, në VKM nr. 165 datë 02.03.2016 “Për grupimin e njësisve të vetëqeverisjes vendore për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të vetëqeverisjes”, VKM nr. 142 datë 12.03.2014 “Për caktimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucioneve të pavarura” dhe VKM nr. 717 datë 23.06.2009 “Për pagat e punonjësve mbështetës të institucioneve buxhetore” të ndryshuar, është miratuar niveli i pagave me Vendimin e Këshillit të Bashkisë nr. 146 datë 22.12.2021 “Për miratimin e nivelit të pagave të punonjësve e të personave të tjerë të zgjedhur ose të emëruar në institucionin e Bashkisë dhe institucioneve të varësisë për vitin 2022”. Kërkohet që në Bashkinë Korçë në kategorinë III.b të shtohet shtesa për pozicion 50.000 dhe në kategorinë III.a/1 të shtohet shtesa për pozicion 64.200, në Ndërmarrjen e Shërbimeve Publike në kategorinë II.b të shtohet shtesa për pozicion 55.000 dhe në III.a/1 të shtohet shtesa për pozicion 60.000 dhe në Ndërmarrjen e Shërbimeve Mbështetëse të Arsimit dhe Çerdhes në kategorinë III.a/1 të shtohet shtesa për pozicion 52.000.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Këto janë në nivel përgjegjësi.

Këshilltari Gj.Kristo: Po.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Më kanë kontaktuar punonjës të ndërmarrjeve të ndryshme mbi situatën e pagës minimale.

Ekzekutivi A.Dishnica: Nuk ka persona nën pagën minimale, ata të cilët iu kanë kontaktuar ju, ose e kanë punën me 7 orë, ose janë me pagë fikse të miratuar plus pastaj edhe vjetërsinë në punë.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Të them unë diçka shkurt për këtë pikë duke u përqëndruar më tepër tek NSHP-ja se aty për shembull kemi inxhinierë që po dalin në pension dhe nuk po na vjen njeri në punë në vend të tyre dhe për këtë arsye po sjellin një rritje të pagave të tyre, ndërsa për pjesën që diskutohet për pagën minimale ne kemi punonjës edhe me më pak orë dhe ndoshta bëhet fjalë për ta.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Dakort, vazhdojmë me votimin.
Hidhet në votim dhe miratohet

Vota PRO 27

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Pika 12 e rendit të ditës

PËR MIRATIMIN E PAGESËS SË VLERËS SË PËRDORIMIT DHE SHITJEN E SIPËRFAQES PREJ 18 M2 TRUALL ME NR.PASURIE 4/1256 VOL.58 FQ.27 ZK 8561 NË PRONËSI TË BASHKISË KORÇË.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Komisioni i Rregullores, Çështjeve Ligjore dhe Administrative dhe Pasurive të Bashkisë, z.Gjergji Kristo mund të vazhdoni.

Këshilltari Gj. Kristo: Nga Agjencia Shtetërore e Kadastres, Drejtoria Vendore Korçë i është bërë me dije Bashkisë Korçë se në kuadër të regjistrimit të një kontrate shitblerje të një pasurie të llojit "njësi" në pallatin me nr.pasurie 4/1034 ZK 8561, pasuri e cila ndodhet pjesërisht mbi pasurinë truall nr.4/1239 vol.56 fq.136 me pronar Bashkia Korçe, nuk mund të kryhet regjistrimi i shitblerjes pa u rregulluar mardhenia me truallin i objektit. Objekti në fjalë është ndërtuar bazuar në lejën e ndërtimit të lëshuar në favor të subjektit ndërtues shoqëria "Ak Konstruksion" me vendim të KRRT nr.10/2 datë 09.04.2009. Sipas dokumenteve kadastrale të komunikuara në kohën e lëshimit të lejës së ndërtimit, leja është lëshuar brenda pronës të kërkuesit. Por, harta është korrigjuar në vijim nga vetë Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, dhe ka rezultuar se godina është ndërtuar mbi pronë shtet me pronar Bashkia Korçë, për vetëm 18 m2 të pasurisë nr.4/1239 ZK 8561. Aktualisht, nuk mund të kryhen transaksione për tjetërsim pronë në këtë godinë, për shkak të fakteve të sipercituara.

Si rrjedhojë, Bashkia Korçë pronar i pasurisë nr.4/1239 me sipërfaqe 1849 m2 truall kërkoi ndarjen e kësaj pasurie, duke veçuar 18 m2 truall të zënë nga godina, për të cilën është lëshuar certifikata e pronësisë me nr.pasurie 4/1256 vol.58 fq.27 ZK 8561. Për të rregulluar mardhënien me truallin, pronari i pasurisë me nr.4/1034 ZK 8561 duhet së pari ti likuadojë Bashkisë Korçë vlerën e përdorimit të sendit të paluajtshëm, pasurisë nr.4/1256 me sipërfaqe 18 m2, duke filluar nga momenti i dhënies së lejës së ndërtimit deri në momentin e kalimit të pronësisë të kësaj pasurie në çastin e nënshkrimit të kontratës noteriale, me vlerën e përcaktuar sipas legjislacionit në fuqi gjatë kohës së përdorimit. Dhe së dyti, Z.Gjergji Skllavi duhet ti blejë Bashkisë Korçë pasurinë e sipërcituar me vlerën e përcaktuar në VKM-në 89 datë 03.02.2016 "Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë".

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Ky është korrigjim besoj që realizohet vetëm në këtë mënyrë.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Kjo është një procedurë për të patur edhe ne sigurinë e pronës që kemi, se për çështje të tilla jemi nëpër gjyq.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Dakort, hedhim në votim vlerat që na janë paraqitur.
Hidhet në votim dhe miratohet

Vota PRO 26

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Hedhim në votim nisjen e procedurave per shitje.

Hidhet në votim dhe miratohet

Vota PRO 26

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Pika 13 e rendit të ditës

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR TRANSFERIMIN NË PRONËSI TË BASHKISË KORÇË TË PASURISË TE LLOJIT SHESH NË PRONËSI SHTET ME SIPËRFAQE 15 300 M2, ME NR.PASURIE 213/2 VOL.23 FQ.140 ZK 2631 NË MBORRJE, DRENOVË, BASHKIA KORÇË, SIPAS GENPLANIT BASHKANGJITUR.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Komisioni i Rregullores, Çështjeve Ligjore dhe Administrative dhe Pasurive të Bashkisë, z. Gjergji Kristo mund të vazhdoni, paraprakisht ju lutem një përmbledhje të shkurtër të materialit.

Këshilltari Gj.Kristo: Bëhet fjalë për pasurinë 213/2 vol.23 fq.140 ZK 2631 me një sipërfaqe prej 15 300 m2. Në kuadër të investimeve që Bashkia Korçë ka për qëllim të realizojë në këtë pasuri në përmbushjen e funksioneve të saj ligjore, nevojitet kalimi në pronësi të Bashkisë Korçë të pasurisë identifikuar sipas genplanit bashkëngjitur këtij relacioni. Baza ligjore e paraqitur në relacion është e saktë kështu që ju ftoj për miratim.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Ka diçka për të shtuar nga këshilltarër apo ekzekutivi?

Këshilltare I.Nikaj: Nga harta për cilën pasuri bëhet fjalë?

Ekzekutivi A.Dishnica: Për 213/2 jo për 213/1 që është e vijëzuar me të kuqe.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Bëhet fjalë për një sipërfaqe që ne kërkojmë të kalojmë në pronësi të Bashkisë me qëllimin e ndërtimit të disa banesave me kosto të ulët për të erdhur në ndihmë të kategorisë më problematike siç është ajo e strehimit, ku përfshihen familje me të ardhura shumë të ulëta, për të mos thënë pa të ardhura fare. Kjo është ideja, të realizojmë këtë projekt edhe me donatorë të ndryshëm për t'i dhënë një zgjidhje edhe strehimit.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Më vjen mirë që mendohen projekte të tilla, sepse ka grupe vërtet në nevojë që jetojnë në kushte minimale jetese dhe pse jo t'iu vijmë në ndihmë me të tilla projekte.

Këshilltare I.Nikaj: Duhej të kishte erdhur edhe më parë ky material, nevoja për strehim është e madhe.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Nuk kishim vendin, sepse projekti mund të bëhet.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Kjo ide ka qënë edhe më përpara, por tani po konkretizohet, sepse ka patur probleme me pronësinë e sipërfaqes dhe tani duhet ta kalojmë në emër të Bashkisë që të mos kemi asnjë pengesë në zhvillimin e projektit që na ka ndodhur shumë herë për shkak të pronësisë.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Dakort, nga këshilltarët ka diçka? Vazhdojmë me votimin.
Hidhet në votim dhe miratohet

Vota PRO 27

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Pika 14 e rendit të ditës

PËR MIRATIMIN E PLANIT VENDOR TË VEPRIMIT PËR MIGRACIONIN DHE DIASPORËN 2022-2025.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Komisioni për Marrëdhëniet me Jashtë dhe Integrimin Europian, nga gjithë Komisioni besoj vetëm z.Kristi Andrea është prezent sot në mbledhje, mund të vazhdoni.

Këshilltari K.Andrea: Bashkia Korçës, në zbatim të funksioneve të reja që i janë shtuar në fushën e Diasporës dhe Migracionit sipas nenit 28/1 dhe 29/1 të Ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, ka nënshkruar Memorandumin e Bashkëpunimit me Nr. 23204/1 prot., datë 10.06.2021, ndërmjet saj dhe Shoqërisë Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar në Shqipëri. Në kuadër të këtij Memorandumi Bashkëpunimi, nga të dyja palët është marrë përsipër realizimi i objektivit për implementimin e projektit “Diaspora dhe Migrantët të angazhuar në fushën e Zhvillimit Ekonomik Vendor”, si dhe i qëllimit për të realizuar zhvillimin e Planit Vendor të Veprimit për Migracionin dhe Diasporën. Vizioni i këtij Plani është garantimi i një mjedisi të sigurt për ri-integrimin e qëndrueshëm ekonomik dhe social të migrantëve duke respektuar, mbrojtur dhe përmbushur të drejtat e tyre njerëzore dhe në të njëjtën kohë të krijojë kushte të favorshme, që i mundëson diasporës përmes kapaciteteve të tyre njerëzore, ekonomike dhe sociale të pasurojë shoqërinë tonë, për të kontribuar në zhvillimin e qëndrueshëm në nivel lokal. Qëllimi i tij është hartimi i një platforme me objektiva strategjike dhe masa të zërthyera në projekte konkrete, që do të hedhin bazat e sistemeve informuese dhe bashkërenduese, mbi migracionin dhe diasporën duke garantuar, riintegrim të qëndrueshëm dhe bashkëpunim frytdhënës me diasporën. Ky dokument mbështetet në disa analiza të thella paraprake të kuadrit ligjor, në harmonizimin e objektivave me kuadrin strategjik qëndror dhe vendor, në hartëzimin e aktorëve të interesit kombëtarë dhe ndërkombëtarë në fushën e migracionit dhe diasporës. Analizat dhe vlerësimet e kryera kanë evidentuar disa sfida të tipologjive si: strukturore e

funksionale, ndërinstitucionale, strategjike e studimore, si dhe informuese e ndërgjegjësuere si: mungesës së të dhënave të sakta mbi migracionin, diasporën dhe të rithyerit, mungesës së procedurave për transaksionin e të ardhurave që do të investohen pranë Bashkisë Korçë, moskoordinimit të pushtetit lokal me atë qendror si dhe midis OJF-ve dhe institucioneve, që kanë në fokus të punës së tyre migracionin, diasporën dhe të rikthyerit, mungesës së një qendre informimi pranë Bashkisë, e cila do të ndihmonte në garantimin e shërbimeve sociale për integrimin/ riintegrimin e emigrantëve të kthyer dhe diasporës. Objektivat strategjike janë: krijimi dhe funksionimi i strukturave vendore për migracionin dhe diasporën; përmbushja e funksioneve për migracionin dhe diasporën sipas kuadrit ligjor; ngritja e Sistemit të të Dhënave, Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit të të Rikthyerve nga Grupet Vulnerabël; ri-Integrimi i qëndrueshëm social dhe ekonomik i migranteve; fuqizimi i rolit të diasporës shqiptare dhe forcimi i bashkëpunimit në zhvillimin social dhe ekonomik lokal.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Ju lutem, pak në mënyrë të përmbledhur.

Këshilltari K.Andrea: Patjetër, po këto janë pika të rëndësishme që duhen përmendur. Megjithatë unë mund të them edhe shkurt që materiali është i plotë dhe i qartë dhe gjëja më e mirë që mund të bëhet është ngritja e një drejtorie përkatëse që merret me këto fusha.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Dua të them diçka në lidhje me këtë material. Fillimisht strukturën për të filluar punën mbi këtë çështje po e nisim, kemi një punonjëse tashmë. Së dyti ajo që na duhet të bëjmë është të mbledhim të dhënat mbi rastet e emigrantëve që janë në lidhje me qytetin tonë dhe së treti të shohim se çfarë mund të bëjmë dhe si mund t'i zgjidhim problematikat që i shqetësojnë këta qytetarë dhe t'i kthejmë në favorin e tyre dhe tonën. Sigurisht që potenciali i tyre për të ngritur dhe financuar biznese dhe jo vetëm është i madh, kjo sepse është treguar si shembull edhe në vitet e përpara dhe pse jo t'i mbështesim dhe t'i kthejmë në forma përfitimi për të gjithë. Mos harrojmë edhe nevojën që kanë një pjesë e tyre për t'i integruar në shoqërinë tonë dhe prandaj realizohen projekte dhe hapa të tillë për t'i ndihmuar duke ditur që nuk janë pak.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Nga këshilltarët ka diçka për të shtuar?

Këshilltari P.Bello: Mua fillimisht më vjen mirë që vijnë projekte të tilla që i japin vëmendje një pjese të rëndësishme të qytetit po edhe popullit tonë, siç është emigracioni. Korça dihet që shquhet për emigrimin e qytetarëve të saj në kohë të hershme sidomos drejt Shteteve të Bashkuara të Amerikës, ku kanë çuar aty dhe e kanë ruajtur dhe trashëguar kulturën dhe traditën tonë ndër breza. Ajo që dua të them është se më tepër se probleme administrative dhe financiare, rëndësi për ta ka më tepër ana shpirtërore.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Faleminderit profesor që përmende edhe pjesën shpirtërore, edhe ajo patjetër që ka rëndësinë e saj. Unë gjithmonë jam përpjekur të krijoj kontakte dhe marrëdhënie me institucionet jashtë sidomos me ato në SHBA, në qytete që janë populluar në një masë të konsiderueshme nga emigrantët shqiptarë dhe konkretisht jam në kontakt me Bashkinë e Bostonit. Në saj të shqiptarëve atje janë ndërtuar Kisha për komunitetin, janë titulluar rrugë dhe

bulevarde, domethënë aktiviteti i tyre në vendin ku kanë emigruar është i madh dhe i qartë, duke mbrojtur dhe ruajtur edhe traditat edhe kulturën tonë.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Unë jam me atë që këta qytetarë, emigrantë, të kthyer apo jo në vendin tonë, nuk duhen parë vetëm si mjet për të përfitur nga investimet apo të ardhurat e tyre, por patjetër duhet parë siç e theksoi edhe profesori ana shpirtërore e tyre.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Patjetër që po, një nga diskutimet tona me Bashkinë e Bostonit është edhe shkëmbimi i eksperiencës mes studentëve shqiptarë me ata amerikanë, si një mjet të shkëmbimit kulturor.

Këshilltari I.Nikaj: Më bëhet qejfi që po i japim rëndësi një çështjeje të tillë, ku më tepër se vlerë ekonomike, vlen ana sociale dhe shpirtërore e tyre, duke ditur gjithë aktivitetet dhe nismat që vet këta emigrantë kanë marrë në vendin ku jetojnë. Ne shpesh lexojmë komente që bëhen nga ta, qoftë pozitive qoftë negative dhe me këto projekte mund t'iu vërtetojmë mbështetjen tonë atje ku ata kanë nevojë. Mua ky projekt më duket shumë pozitiv dhe ju ftoj ta mbështesim.

Ekzekutivi E.Ilia: Këto janë vetëm hapat e parë që po ndërmerren për pjesën e emigracionit dhe diasporës. Sigurisht që ka shumë punë përpara, duhen studime të mirëfillta, nuk është vështirë vetëm nga pjesa e përfitimit ekonomik nga ata, absolutisht do të përfshihen të gjitha dimensionet e veprimtarisë së tyre.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Ka diçka për të shtuar nga këshilltarët?

Këshilltari R.Themeli: Mbaj mend që u propozua disa kohë më parë zhvillimi i një maratone në bashkëpunim me disa përfaqësues të Bostonit, është miratuar për të qënë pjesë e këtij materiali?

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Unë jam shumë i interesuar të bëhen aktivitete të tilla, por për momentin nuk është realizuar diçka e tillë në këtë material, të shohim në vazhdim kur të avancojë puna çfarë mund të realizohet.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Vazhdojmë me votimin.

Hidhet në votim dhe miratohet

Vota PRO 26

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Pika 15 e rendit të ditës.

PËR NJË SHITESË NË V.K.B-në NR.13 DATË 02.02.2022 "MIRATIMIN E REZOLUTËS"
"PËR RISHIKIMIN E DRAFT-HARTËS GJYQËSORE".

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Përpara se të kalojmë tek informacioni, na duhet të miratojmë një shtesë të rezolutës që ne hartuam dhe votuam herën e kaluar, sepse kishim harruar të miratonim dërgimin e saj edhe në KLGJ. Unë sëbashku edhe me disa këshilltarë ishim pjesë e takimit që u bë për vendosjen e kësaj hartës së re gjyqësore që ata pretendojnë. Sigurisht ata shtruan argumentat e tyre ashtu siç ata i kishin llogaritur apo logjikuar dhe patjetër që edhe ne shtruan argumentat tonë ashtu siç i diskutuam. Ata ishin bazuar tek aspekti ekonomik, financiar i institucionit të tyre, pa marrë parasysh aspektin social, impaktin në shoqëri të një veprimi të tillë. Ata flisnin në rang Shqipërie dhe jo për kushte dhe karakteristika të rajoneve të ndryshme të vendit. Si përfundim e thashë edhe më herët, në materialin që miratuam nuk kishim përfshirë dërgimin e rezolutës sonë tek KLGJ-ja. Kështu që ju ftoj ta votojmë këtë shtesë.

Këshilltari I.Nikaj: Unë isha pjesë e atij takimi dhe absolutisht mendoj se mbrojtja që i bëhej atij projekti nuk ishte i mjaftueshëm dhe i formuluar mirë. Përveç faktit që ata nuk kishin marrë fare për bazë aspektin socio-ekonomik të rajonit tonë po flas, flisnin edhe për një rrezik korrupsioni në zona të vogla të rajoneve më të madhë sesa në qendër gjë që nuk qëndron aspak dhe për më tepër bazoheshin në të dhëna dhe shifra të vitit 2020 ku të gjithë e dimë se ishte një vit i vështirë nga pandemia ku u paralizua gjithçka. Këto fakte për mua nuk qëndrojnë dhe janë të gabuara nga ana e tyre. Madje unë iu bëra edhe propozimin që për shkak të gjithë zhvillimit ekonomik, social, infrastrukturor që qyteti ynë po merr le të mbetet Gjykata e Apelit në Korçë dhe le të vijë pse jo qytetarët e Tiranës këtu.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Kalojmë në votim.

Hidhet në votim dhe miratohet

Vota PRO 26

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Pika 16 e rendit të ditës.

INFORMACION MBI DETAJIMIN E SHPENZIMEVE KORRENTE DHE SHPENZIMEVE PËR INVESTIMEVE TE VITIT 2022 TË MIRATUARA ME VKB NR. 147 DATË 22.12.2021 “MBI MIRATIMIN E BUXHETIT VJETOR 2022 TË BASHKISË KORÇË” DHE VKB NR. 6 DATË 27.1.2022 “PËR RISHQYRTIMIN E VKB NR. 147 DATË 22.12.2021 “PËR MIRATIMIN E BUXHETIT VJETOR 2022 TË BASHKISË KORÇË”.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Informacioni na është shpërndarë me e-mail, megjithatë disa kopje të printuar duheshin.

Ekzekutivi V.Ziko: Ky është një material që ne e sjellin për formalitet, sepse ai vet është pjesë buxhetit që ne kemi miratuar, është detyrim ligjor.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Nuk ka ndryshime fare nga shifrat që ne kemi parë.

Ekzekutivi V.Ziko: Jo fare, këto janë thjesht detajime. Përderisa ai është pjesë e buxhetit të miratuar dhe publikuar, çdo gjë është transparente.

Pika 17 e rendit të ditës.

KËRKESA –ANKESA TË QYTETARËVE.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Kërkesa e parë na ka erdhur nga shoqata "Balkan Youth Activism", përfaqësuesi i tyre është këtu, mund të vazhdoni.

Përfaqësuesi G.Haxhillari: Të nderuar, ju falenderoj për mundësinë e shfaqjes së kërkesës sonë në Këshillin Bashkiak Korçë. Arsyeja pse unë jam këtu është kërkesa që ne ju kemi çuar për rikategorizimin e shoqatës "Balkan Youth Activism" dhe mos-taksimim e saj nga Bashkia Korçë. Ne jemi e vetmja organizatë rinore e regjistruar në databazën e Bashkisë Korçë, e themeluar në 07.06.2018 dhe kemi përfaqësuar Shqipërinë në kohë pandemie në 15 shtete deri në Rusi dhe SHBA. Ajo që ne synojmë është krijimi i kontakteve me organizatat rinore në SHBA, konkretisht në Detroit dhe Teksas. Gjithë veprimtaria jonë është në mënyrë vullnetare dhe të gjitha kostot e aktiviteteve që kemi shpjeguar edhe në kërkesën tonë jemi munduar t'i shlyejmë nga xhepat tanë. Arsyeja e ardhjes sime është falja ose heqja e taksave për organizatat rinore dhe kërkojmë që edhe organizata e tjera rinore që do të vijnë t'iu mundësohet një situatë dhe kushte më të lehta veprimi.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Kërkesa juaj është e drejtë, por kjo nuk mund të diskutohet tani, sepse lidhet me paketën fiskale, ku në këto momente ne nuk mund të ndërhyjmë. Nëse kjo kërkesë do të kishte erdhur në një moment tjetër, para miratimit të paketës vlente si kërkesë, megjithëse ne i kemi marrë disa hapa ndryshe për taksat e OJF-ve. Megjithatë mund ta kemi parasysh në miratimin e paketës tjetër fiskale.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Një tjetër kërkesë vjen nga shoqata "Gorë-Opar e Bashkuar", për vlerësimin e kontributit të Dr. Syrja Jahollari duke e cilësuar si "Qytetar Nderi" dhe në material ju besoj e keni përpara janë dhënë disa shpjegime të veprimtarisë së tij.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Do t'i kalojë Komisionit përkatës për shqyrtim.


Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Unë do të sugjeroja që të bënim një evidentim të gjithë titujve që na janë kërkuar dhe që iu kemi dhënë për të evituar atë pjesën e ngatërresave dhe dhënies së titujve edhe për persona që ndoshta kanë marrë tituj edhe më të lartë se ata që japim ne.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Do e kemi parasysh, do kemi kujdes me titujt që japim.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Ju falenderoj për pjesëmarrjen.

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Eva Naçi



KRYETARI

ERJON NEXHIPI

